



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-30972 /2023

Klinë, datë 09/09/2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, më dt. 04.06.2008, nr.28, dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, dispozitat e Rregullores së MAPL nr.02/2021 për Hartimin dhe Publikimin e Akteve të Komunës, dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Kryetari i Komunës së Klinës, mori këtë;

### V E N D I M

*Për formimin e grupit punues për plotësim ndryshimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale*

1. **CAKTOHET**, grupi punues për hartimin e Draft Rregullores për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Komunale për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale. Përbërja e grupit punues do të jete si në vijim:
  - 1.1. **Ajet Sejdiu, kryesuese;**
  - 1.2. **Ali Gashi, anëtare;**
  - 1.3. **Burim Hoti, anëtare;**
  - 1.4. **Adnan Zeneli, anëtarë si dhe;**
  - 1.5. **Mirsad Dakaj, anëtare.**
2. Grupi punues është përgjegjës për hartimin e projekt propozimit si nga pika 1 e këtij vendimi, marrjen e propozimeve dhe komenteve nga ana e drejtorive përkatëse, diskutimet publike dhe vendosjen lidhur më pranimin apo jo të tyre, hartimin e raportit të shqyrtimit publik, si dhe obligimet tjera qe dalin nga dispozitat ligjore e nënligjore pozitive.
3. Më rastin e përfundimit të procedurave të hartimit dhe diskutimit publik drafti final i dërgohet kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Të përmendurit;
- Drejtoritë komunale;
- Zyra e Informimit, si dhe;
- Arkivi.



Kryetari,  
Zenun Elezaj